

VENDIM
Nr. 495, datë 29.6.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 8, DATË 14.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MBROJTJEN E SHTRESAVE NË NEVOJË, PËR EFEKT TË HEQJES SË FASHËS SË KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DERI NË 300 kwh NË MUAJ"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 1, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", dhe të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Financave dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 8, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja "c", riformulohet, si më poshtë vijon:

"Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie shtetëror, pension pleqërie fshati ose pension social, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar."

b) Pas shkronjës "dh" shtohet shkronja "e", me këtë përmbajtje:

"Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie ose pension social që janë me banim në fshat, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët."

2. Pas paragrafit të parë, të pikës 2, shtohen paragrafi i dytë dhe i tretë, me këtë përmbajtje:

"Në rastet kur në të njëjtën familje ka dy pensionistë të vetëm dhe kontrata është në emër të pensionistit jokryefamiljar, kompensimin e përfiton pensionisti në emër të të cilit është kontrata e energjisë elektrike.

Në rastet kur, si e ardhur e vetme e familjes është pensioni familjar dhe kontrata është në emër të kryefamiljarit pasjetues, të fëmijëve ose në emër të kryefamiljarit të vdekur, kompensimi u akordohet personave përfitues të pensionit familjar."

3. Pas paragrafit të parë të pikës 3, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Edhe nëse përfituesi plotëson kriteret e përfitimit, kompensimi nuk përfitohet nëse nuk ka konsum të energjisë elektrike dhe paguhet vetëm tarifa fikse e shërbimit."

II. Efektet financiare nga zbatimi i këtij vendimi përlogariten në shumën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë dhe përballohen brenda fondeve të buxhetit të sigurimeve shoqërore të vitit 2016.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi